DEKRET
Nr. 438, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa "ç", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1
Dhënien e dekoratës "Ylli i Madh i Urdhrit të Skënderbeut"
zotit Besim Elezi

"Në shenjë vlerësimi për kontributin e jashtëzakonshëm në zhvillimin e shkencës mjekësore shqiptare, për profesionalizmin e lartë dhe përkushtimin e vyer në modernizimin e praktikave kirurgjikale, si dhe për rolin thelbësor në formimin e brezave të mjekëve e kirurgëve. Në nderim të veprimtarisë së pasur profesionale dhe akademike, që ka ndihmuar në konsolidimin e standardeve të mjekësisë kirurgjikale në shërbim ndaj qytetarëve dhe shtetit".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj